



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 14396 Prot.

Vlorë, më 16.11, 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ 2023

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT TËPUNËS TË AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT  
TË BASHKISË VLORË PËR PERIU DHËN JANAR-DHJETOR 2024”**


Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, Nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 gërma b, Nenit 54 pika k dhe n, të Ligjit Nr.139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Nenit 118 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit të Bashkisë Vlorë”, si dhe bazuar në relacionin e Konferencës së Kryetarëve të Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_

**VENDOSI:**

1. Miratimin e programit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Vlorë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Këshilli dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 55, pika 6.

Konceptoi: Daut Zëraj 





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_\_ 2023

**RELACION**

**Mbi projektvendimin “Për miratimin e Programit të Punës të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë për vitin 2024”.**

**Para : Këshillit të Bashkisë**

Të nderuar Keshilltarë!

Projektvendimi që ju paraqesim për miratim, lidhet me programin e aktiviteteve të këshillit të bashkisë, për vitin 2024, i cili është një dokument i rëndësishëm, që orienton procedurat vendimmarrëse, për të zbatuar sa më mirë dispozitat ligjore, udhëzimet dhe rregulloret përkatëse, por mbi të gjitha për të marrë vendime sa më të drejta për qytetarët.

Ky program aktiviteteve, është gjithashtu në respektim të procedurave të parashikuara në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionin e Këshillit të Bashkisë”.

Programi i punës, ka në përbërjen e vet një plan aktiviteteve mujore, bazuar kjo në detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe në Rregullore, Dokumente strategjike të Bashkisë, Planin e Përgjithshëm Vendor, si dhe eksperiencat e viteve të mëparshme, etj.

Në muaj të ndryshëm janë parashikuar edhe tema të rëndësishme siç janë: Fushata ndergjegjëse në bashkëpunim me këshillat rinorë, informacione të ndryshme nga drejtoritë e bashkisë etj.

Gjithashtu programi i aktiviteteve ka në përbërjen e vet një program konsultimi me publikun, bazuar në Ligjin për Konsultimin Publik dhe Rregulloren e Këshillit për konsultimet publike. Neni 16 dhe 18 i Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, detyron këshillin bashkiak të organizojë konsultime publike për vendimet që merr, kur bëhet fjalë për buxhetin,

ndryshimet përkatëse të tij, si dhe çështje të tjera që lidhen me pikat “a”, “dh”, “e”, “f”, dhe “k” të Nenit 54 të Ligjit të sipërcituar. Ndërkohë, Rregullorja “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë” parashikon procedurën se si duhet të zhvillohet ky konsultim publik. Theksojmë gjithashtu se ky program aktivitetesh është konsultuar paraprakisht edhe në Konferencën e Kryetarëve të Këshillit të Bashkisë dhe i paraqitet për miratim Këshillit pasi ka marrë dakortësinë e kësaj strukture të Këshillit të Bashkisë.

Është e kuptueshme se ky program vjetor aktivitetesh, nuk mund të parashikojë gjithë veprimtaritë që zhvillon këshilli i bashkisë, në një periudhë 1-vjeçare. Por, sidoqoftë, do të shërbejë si një orientues për këshillin e bashkisë, lidhur me procedurat e organizimit dhe funksionimit gjithë vjetor. Ndërkohë, këshilltarët mund të bëjnë propozime të tjera sidomos, për të trajtuar problematika të ndryshme të konstatuara prej tyre, të cilat duhet të përmirësohen. Kjo, pasi, ky program i jep mundësinë këshillit, por edhe administratës së bashkisë që, të parashikojnë në kohë çështje për diskutim, analizë dhe vendimmarrje, duke evituar trajtimin e tyre vetëm në pikën, ”të ndryshme” të rendit të ditës të mbledhjes së këshillit.

Nga sa më lartë, për këshillin e bashkisë si një organ kushtetues i pavarur, vendimmarrës, përfaqësues i Komunitetit, ky dokument është i rëndësishëm. Ky program duhet të vlerësohet edhe nga komisionet dhe nga drejtoritë që ta zbatojnë me korrektesë duke mundësuar dhe depozitim të materialeve në kohë dhe në afatin e përcaktuar. Natyrisht ky program merr parasyh dinamikën e aktiviteteve në komunitet dhe mund të jetë subjekt rishikimi, në vijimësi.

Duke theksuar mundësinë e rishikimit në vijimësi të këtij programi, kërkojmë nga këshilli i bashkisë, ta miratojë atë, me qëllim që të përdoret si orientues i aktiviteteve të këshillit gjatë vitit 2024 si dhe nxitje për administratën e bashkisë në funksion të realizimit të detyrave të bashkisë, si organ i veqeverisjes vendore.

Ju faleminderit !

Konceptoi: Daut Zëraj 





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VJORË  
KËSHILLI I BASHKISË

**Programi i Punës të Aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë për vitin 2024**

Muaji	Aktivitete të planifikuara	Autoriteti përgjegjës	Referenca ligjore dhe dokumente të tjera
-------	----------------------------	-----------------------	--

<p><b>J A N A R</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të Këshillit Bashkiak</p> <p>-Mbledhja e Këshillit (1)</p> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <p>1-Performanca dhe problematikat e punës së drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, gjatë vitit 2023.</p> <p>2-Miratimi i dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</p> <p>3-Raport mbi veprimtarinë e keshillit për vitin 2023.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- K.B</li> <li>- Sekretari</li> <li>- Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</li> <li>- Komisionet përkatëse të KB</li> </ul>	<p>Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”</p> <p>Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e KB</p>
---	--	--	--

<p><b>S</b> <b>H</b> <b>K</b> <b>U</b> <b>R</b> <b>T</b></p>	<p>➤ <i>Vepërimitarët:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të këshillit sipas tematikës së mbledhjes.</p> <p>-Mbledhja e Këshillit (1)</p> <p>- <i>Tematika e mjaftit:</i></p> <p>1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe të ardhurat e bashkisë</p> <p>2-Raport mbi performancën e punës së Drejtorisë së Mbrojtjes Civile.</p> <p>3-Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e KB.</p>	<p>K.B</p> <p>-Sekretari</p> <p>-Komisioni i ekonomisë, financës dhe privatizimit.</p> <p>-Komisioni i çështjeve juridike, rendit dhe i sigurisë vendore publike.</p> <p>-Komisioni i Mandateve dhe Rregullores.</p> <p>-Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</p>	<p>-Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”</p> <p>-Rregullore e këshillit bashkiak</p>
--	---	---	---

<p><b>M R A S</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të keshillit bashkiak sipas tematikës së mbledhjes .</p> <p>-Mbledhja e Këshillit.(1)</p> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <p>1-Miratimi i buxhetit faktik i vitit 2023.</p> <p>2-Raport mbi situatën dhe problematikat e sektorit të bujqësisë,bordit të kullimit si dhe situata e administrimit të pyje ve dhe kullota.</p> <p>3-Miratimi i tavanave përgatitore të shpenzimeve për çdo program buxhetor për PBA 2025 – 2027.</p> <p>4-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</p>	<p>-K.B</p> <p>-Sekretari</p> <p>-Komisioni i ekonomisë,financës dhe privatizimet.</p> <p>-Komisioni i çështjeve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike.</p> <p>-Komisioni i bujqësisë, pyjeve dhe menaxhimit të ujrave.</p> <p>- Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</p>	<p>-Ligji 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”</p> <p>-Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e vetqeverisjes vendore”.</p>
<p><b>P R I L L</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të keshillit bashkiak.</p> <p>-Mbledhja e Këshillit.(1)</p> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <p>1-Performanca e sektorit të pastirimit si dhe të sektorit të ndriçimit.</p> <p>2-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</p> <p>3-Raport mbi performancën e shoqërive aksionere në pronësi të Bashkisë Vlorë.</p> <p>4- Fushata ndergjegjësuere te keshillit bashkiak ne</p>	<p>-KB</p> <p>-Sekretari</p> <p>-Komisioni i ekonomisë, financës, dhe privatizimit.</p> <p>-Komisioni i çështjeve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike.</p> <p>-Strukturat përkatëse të</p>	<p>-Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”</p> <p>- Rregullore e keshillit bashkiak.</p>

	bashkepunim me keshillat rinor.	administratës së bashkisë	
<b>M</b> <b>A</b> <b>J</b>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e Komisioneve të keshillit bashkiak</p> <p>-Mbledhja e Këshillit.(1)</p> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <p>1-Analizë e raportit të 4-mujorit të veprimtarisë financiare të Bashkisë.</p> <p>2- Informacion mbi masat e marra për mbrojtjen nga zjarret nga MSZH-ja dhe mbi masat e marra për çeljen e sezonit turistik.</p> <p>4-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</p>	<p>-KB</p> <p>-Sekretari</p> <p>-Komisioni i ekonomisë, financës dhe privatizimet.</p> <p>-Komisioni i çështjeve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike.</p> <p>-Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</p>	<p>-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"</p> <p>-Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore".</p> <p>- Rregullore e keshillit bashkiak.</p>



<p><b>Q</b> <b>E</b> <b>R</b> <b>S</b> <b>H</b> <b>O</b> <b>R</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak. -Mbledhja e këshillit</p> <p>➤ <i>Tematika e muqjit:</i></p> <p>1-Miratimi i draftit të PBA-së 2025 - 2027dhe rekomandimeve. 2-Raport mbi problematikat e rregjistrimit të pasurive të paluajtëshme të bashkisë. 3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</p>	<p>-KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë, financës, dhe privatizimet -Komisioni i gëshjveve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike.</p> <p>-Strukturat përkatëse të administratës së bashkië.</p>	<p>-Ligji 139/2015,“Për vetëqeverisjen endore” -Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e vetqeverisjes vendore”.</p>
<p><b>K</b> <b>O</b> <b>R</b> <b>R</b> <b>I</b> <b>K</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak. -Mbledhja e këshillit .</p> <p>➤ <i>Tematika e muqjit:</i></p> <p>1-Miratimi i Tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2025 -2027 në nivel programi. 2-Raport mbi problematikat e arsimit parashkollor të bashkisë. 3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</p>	<p>-KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë, financës dhe privatizimit -Komisioni i gëshjveve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike. -Komisioni i arsimit kulturës dhe sportet. -Strukturat e administratës së bashkisë.</p>	<p>-Ligji 139/2015,“ Për vetëqeverisjen vendore”. -Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e vetqeverisjes vendore”.</p>

<p><b>G</b> <b>U</b> <b>S</b> <b>H</b> <b>T</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbledhja e komisioneve të këshillit.</li> <li>-Mbledhja e këshillit.</li> </ul> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1-Analizë e komisionit të barazisë gjinore dhe problematikave sociale.</li> <li>2-Raport mbi performancën e drejtorisë së Urbanistikës, lidhur me menaxhimin e territorit në fushën e ndërtimeve.</li> <li>3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-KB</li> <li>-Sekretari</li> <li>-Komisioni i çështjeve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike.</li> <li>-Komisioni i ekonomisë, financës dhe privatizimit</li> <li>-Komisioni i barazisë gjinore.</li> <li>-Komisioni i zhvillimit urbanistik dhe ndërtimet.</li> <li>-Strukturat e administratës së bashkisë.</li> </ul>	<p>-Ligji 139/2015, 'Për vetëqeverisjen vendore'.</p> <p>- Rregullore e këshillit bashkiak.</p>
---	---	---	---

<p><b>S H T A T O R</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbledhja e komisioneve të këshillit</li> <li>-Mbledhja e këshillit</li> <li>-Dëgjesa publike për PBA-në</li> <li>-Trajtime per keshillaret e rinj ne bashkepunim me BtF.</li> </ul> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1-Analizë e raportit të 4-mujorit të dytë mbi realizimin e të ardhurave të bashkisë.</li> <li>2-Raport mbi masat e marra për fillimin e vitit të ri arsimor.</li> <li>3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</li> </ol>	<p>-KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë,financës dhe privatizimit. -Komisioni i çështjeve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike. -Komisioni i arsimit,kulturës dhe sportet -Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë</p>	<p>Ligji 139/2015, 'Për vetëqeverisjen vendore" Ligji 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik". -Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e vetqeverisjes vendore".</p>
---	--	---	---

<p><b>T E R T O R</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbledhja e komisioneve të këshillit.</li> <li>-Mbledhja e këshillit.</li> </ul> <p>➤ <i>Tematika e muqijt:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1-Raport mbi performancën e punës së drejtorisë së Aseteve dhe Menaxhimit të Pronave Publike, lidhur me procedurat e shpronësimit.</li> <li>2-Raport mbi ecurinë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2023.</li> <li>3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-KB</li> <li>-Sekretari</li> <li>-Komisioni i ekonomisë,financës dhe privatizimit.</li> <li>-Komisioni i gëshjtjeve juridike,rendit dhe i sigurisë vendore publike.</li> <li>-Komisioni i shërbimeve publike , transportit, investimeve dhe strehimit.</li> <li>-Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</li> </ul>	<p>-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".</p> <p>- Rregullore e këshillit bashkiak.</p>
---------------------------	--	---	---

<p><b>N E N T O R</b></p>	<p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbledhja e komisioneve të keshillit.</li> <li>-Mbledhja e keshillit.</li> <li>Konsultime publike për buxhetin 2025.</li> </ul> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1-Miratimi i paketës fiskale e vitit 2025.</li> <li>2-Problematikat në lidhje me shërbimet publike si dhe masat për përmirësimin e këtij shërbimi.</li> <li>3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</li> </ul>	<p>-KB</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Të gjitha komisionet e keshillit.</li> <li>-Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</li> </ul>	<p>-Ligji 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore".</p> <p>Ligji 146/2014, "për njoftim dhe konsultim publik".</p> <p>-Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e vetqeverisjes vendore".</p>
---------------------------	---	--	--

<p><b>D H H J E T O R</b></p> <p>➤ <i>Veprimtarië:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbledhja e komisioneve të kështillit</li> <li>-Mbledhja e kështillit</li> </ul> <p>➤ <i>Tematika e muajit.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1-Miratimi i buxhetit të vitit 2025 si edhe PBA 2025 – 2027.</li> <li>2-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e bashkisë.</li> <li>3-Raport mbi performancën e Policisë bashkiake dhe problematikat në menaxhimin e territorit , referuar kundravajtjeve administrative.</li> </ol>	<p>-KB</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Të gjitha komisionet</li> <li>-Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</li> </ul>	<p>-Ligji 139/2015,“Për veteverisjen vendore”.</p> <p>-Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e vetqeverisjes vendore”.</p>
--	---	---

Sqarim: Në këtë plan aktivitetesh nuk janë përfshirë çeshtje të ndryshme që mund të vijnë nga administrata e bashkisë,përfshirë dhe ndryshimet e buxhetit.

Gjithashtu çdo anëtar i kështillit rezervon të drejtëngjë gjatë vitit të përfshijë tematika dhe çeshtje të ndryshme të cilat ai/ajo mendon se ndikon në pëmirësimin e treguesve të performancës së punës së administratës së bashkisë dhe të kështillit në shërbim të komunitetit.

